

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 26 Prot

Peshkopi, më 03.01.2024

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.138


Datë: 29.12.2023

**“Për trajtimin financiar të nxënësve në institucionet arsimore publike për vitin
mësimor 2023-2024”**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.18/1 prot.

Peshkopi, më 04.01.2024

Lenda : Për vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.138 date 29.12.2023

BASHKISË DIBER

DIBER

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.138, date 29.12.2023 "Për trajtimin financiar të nxënësve në institucionet arsimore publike për vitin mësimor 2023-2024", konstatova se:

Akti administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi bën pjesë në kategorinë e akteve me karakter individual për pasojë nuk është në kompetencë të Prefektit të shprehet për ligjshmërinë e kësaj vendimmarrje, veprim që kurdoherë është përgjegjësi direkte administrativo-ligjore e strukturës së posaçme të Bashkisë Dibër që paraqet për miratim projekt akte të kësaj natyre.

Aktet administrative të karakterit individual, hyjnë në fuqi menjëherë sipas përcaktimit të nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

PREFEKTI
- Nexhbedin SHEHU -



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 138 Datë 29 / 12 /2023

“Për trajtimin financiar të nxënësve në institucionet arsimore publike për vitin mësimor 2023-2024”

Në bazë të VKM nr. 666, datë 10.10.2019: “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, për përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, të ndryshuar për vitin shkollor 2023-2024”, dhe në mbështetje të Ligjit Nr.69/2012 “Për sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 32, të Ligjit 15/2017, “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë” si edhe bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga nxënësit, që ndjekin arsimin profesional me kohë të plotë në institucionet arsimore publike, të interesuar për tu trajtuar me bursë, sipas VKM nr. 666, datë 10.10.2019 dhe Vendim Nr.511, datë 27.07.2022 të ndryshuar, sipas secilës pikë, për kategoritë përkatëse si më poshtë vijon:

Pika 2.2 “Nxënësit e arsimit profesional, të cilët kanë mbaruar vitin shkollor paraardhës me notën mesatare (nëntë) deri në (dhjetë)”

Pika 2.1/g “Nxënësit me një prind”

Pika 2.3/dh “Nxënësit e pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane, të cilët regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional”

Pika 2.3/c “Nxënësit të cilët gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, si dhe nxënësit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga komisioni mjeko-ligjor”

Pika 2.3/d “Nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit”

Vendim 511 datë 27.07.2022 pika 2.3/gj "Nxënëset, të cilat regjistrohen në arsimin profesional në të gjitha drejtimet mësimore, trajtohen me 50% të bursës"

Vendim 511 datë 27.07.2022 pika 2.1/c e ndryshuar "Nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë." **Pika 29.** "Ministria përgjegjëse për arsimin profesional për të gjitha kategoritë e nxënësve që ndjekin arsimin profesional, të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi", Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **29.12.2023**, me 24 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Trajtimin me bursë të nxënësve të kategorive përkatëse të mësipërme sipas listave bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike, Sektori Arsimit dhe Kulturës, Bashkia Dibër.
3. Për vendimin e lartëcituar njoftohet institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër dhe hyn në fuqi menjëherë.
4. Vendimi u shpall me datë **29.12.2023**.

Kryetare e Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
SEKTORI I ARSIMIT DHE KULTURËS

PROJEKT- VENDIM

Nr. 09 datë 10.12, 2023

PËR

**“TRAJTIMIN FINANCIAR TË NXËNËSVE NË INSTITUCIONET
ARSIMORE PUBLIKE PËR VITIN MËSIMOR 2023-2024”**

Në bazë të VKM nr. 666, datë 10.10.2019: “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, të ndryshuar për vitin shkollor 2023-2024”, dhe në mbështetje të Ligjit Nr.69/2012 “Për sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 32, të Ligjit 15/2017, “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë” si edhe bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga nxënësit, që ndjekin arsimin profesional me kohë të plotë në institucionet arsimore publike, të interesuar për tu trajtuar me bursë, sipas VKM nr. 666, datë 10.10.2019 dhe Vendim Nr.511, datë 27.07.2022 të ndryshuar, sipas secilës pikë, për kategoritë përkatëse si më poshtë vijon:

Pika 2.2 “Nxënësit e arsimit profesional, të cilët kanë mbaruar vitin shkollor paraardhës me notën mesatare (nëntë) deri në (dhjetë)”

Pika 2.1/c “Nxënësit me një prind”

Pika 2.3/dh “Nxënësit e pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane, të cilët regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional”

Pika 2.3/c "Nxënësit të cilët gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, si dhe nxënësit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga komisioni mjeko-ligjor"

~~Pika 2.3/d "Nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit"~~

Vendim 511 datë 27.07.2022 pika 2.3/gj "Nxënëset, të cilat regjistrohen në arsimin profesional në të gjitha drejtimet mësimore, trajtohen me 50% të bursës"

Vendim 511 datë 27.07.2022 pika 2.1/c e ndryshuar "Nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë." Pika 29. "Ministria përgjegjëse për arsimin profesional për të gjitha kategoritë e nxënësve që ndjekin arsimin profesional, të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi"

i propozojmë Këshillit Bashkiak të vendosë:

Trajtimin me bursë të nxënësve të kategorive përkatëse sipas listave bashkëngjitur.

Specialiste e Arsimit

Alma LLESHI



Përgjegjëse e Sektorit Arsimit dhe Kulturës

Valbona KALOÇI



Drejtori Juridik

Ismet SARACI

~~Sekretar i Këshillit Bashkiak~~

Ilir ELEZI

Kryetari i Bashkisë

Rahim SPAHIU

